



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.31, datë 01.08.2023

**PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT ME FUNKSIONE KOMPLEKSE, SHËRBIMI, HOTELERI DHE
REZIDENCIALE ME 5, 6 DHE 25 KATE MBITOKË DHE 5 KATE NËNTOKË”, ME
VENDNDODHJE NË RRUGËN “LIMAN KABA”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Unico Construction” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt me funksione komplekse, shërbimi, hoteleri dhe rezidenciale me 5, 6 dhe 25 kate mbitokë dhe 5 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Liman Kaba” Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Unico Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 37, datë 25.04.2023 “Për miratim e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë banimi, shërbimi dhe funksione të përziera”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I MINISTRAVE

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



[Handwritten signature in blue ink]

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA ROTA



[Handwritten signature in blue ink]